



Instituti Kombëtar i Statistikës
Presidenti

LINGUA ALBANESE

Romë, 8 janar 2015

E nderuar Zonjë, i nderuar Zotëri,

Çdo vit, që nga 1959-ta, Instituti kombëtar i statistikës zhvillon anketën mbi forcat e punës, që disiplinahej prej disa vitesh, nga rregullorja (CE) n. 577/98. Anketa, nëpërmjet informacioneve të mbledhura drejtpërdrejt prej qytetarëve, jep të dhëna për punësimin e për papunësinë, absolutisht të domosdoshme për njohjen e dinamikës sociale dhe ekonomike të vendit.

Sipas moshës e përvojës, njerëzit do t'i përgjigjen pyetjeve të ndryshme. Të punësuarit do të përgjigjen për profesionin e tyre dhe për karakteristikat e veprimtarisë së punës. Ata që nuk janë në punë – pensionistët, shtëpiaket, studentët, të papunët, etj. – do të japin informacione për arsyet përse nuk punojnë e për punët që mund të kenë bërë më parë.

Emri juaj është nxjerrë me short nga lista e gjendjes civile që përmban emrat e të gjitha familjeve rezidentë në Komunë.

Bashkëpunimi juaj dhe i familjarëve tuaj do të jetë thelbësor për përfundimin e mbarë të anketës në kuadrin e Programit statistikor kombëtar (kodi IST – 00925), që përmbledh tërësinë e të dhënave statistikore me interes publik.

Për këtë arsye, Ju ftoj t'ia komunikoni përmbajtjen e kësaj letre familjarëve që jetojnë më Ju dhe të mirëprisni të ngarkuarin tonë.

Një intervistues që mbledh të dhënat për llogari të Istat, i pajisur me dinstiktivin identifikues, do të vijë në shtëpinë tuaj ditët e ardhshme, për t'ju bërë disa pyetje juve dhe familjarëve tuaj. Ju mund të caktoni një takim, si në rastin kur intervistuesi vjen drejtpërdrejt në banesën tuaj, ashtu edhe në rast se ju telefonon për të caktuar datën për intervistën. Pasi të kalojnë 40 ditë nga marrja e kësaj letre, në rast se intervistuesi ynë nuk ju kontakton, mund ta konsideroni veten të lirë nga çdo angazhim.

Istat është i detyruar me ligj të zhvillojë këtë anketim dhe qytetarët janë të detyruar të marrin pjesë.

Informacionet e mbledhura, të mbrojtura nga sekreti statistikor e që i nënshtrohen ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të përdoren edhe për përpunime të mëpasshme, vetëm për qëllime statistikore, nga ana e subjekteve të Sistemit statistikor kombëtar e do të shpërndahen në trajtë të mbledhur në mënyrë të tillë që të jetë i mundshëm identifikimi i personave që i japin, duke siguruar kështu karakterin e rezervuar në maksimum. Gjithashtu, të dhënat mund të komunikohen për qëllime kërkimore shkencore sipas kushteve e sipas mënyrave të parashikuara nga neni 7 i Kodit të deontologjisë për trajtimet e të dhënave personale të bëra në kuadrin e Sistemit statistikor kombëtar e nga rregullorja (UE) n. 557/2013.

Përgjegjës i trajtimit statistikor të të dhënave të mbledhura, në kuadrin e kësaj ankete, është Drejtori i përgjithshëm i statistikave shoqërore-ekonomike. Për trajtimin e të dhënave personale, i ngarkuar është Istat - Instituti kombëtar i statistikave, rruga Cesare Balbo 16 - 00184 Romë, e përgjegjës është Drejtori i përgjithshëm (i lartpermendur), të cilit mund t'i drejtoheni edhe për të njohur listën e plotë të përgjegjësve e përse i përket ushtrimit të të drejtave të interesuarve.

Për informacione të mëtejshme mund t'i drejtoheni ISTAT-it, duke telefonuar në numrin jeshil (falas) 800676767 nga e hëna deri të shtunën, nga ora 12:30 deri ne 20:00, ose mund të konsultoni faqen e internetit <http://www.istat.it/it/supporto/per-i-rispondenti>.

Përfitojmë nga rasti tju kujtojmë që në faqen e internetit <http://www.istat.it> janë publikuar informacionet relative të organizimit e aktivitetit të Istat

Ju falënderoj që në këtë çast për bashkëpunimin që do të na jepni e ju lutem të pranoni përshëndetjet më të mira për Ju e familjen tuaj.

Giorgio Alleva

**SEKRETI STATISTIKOR, DETYRIMI I PËRGJIGJES, TUTELIMI I
REZERVIMIT DHE TË DREJTAT E TË INTERESUARVE**

- Rregullorja (CE) e Këshillit të 09 marsit 1998, n. 577/98 e modifikime e plotësime të mëtejshme, për organizimin e anketës me kampion mbi forcat e punës në Komunitet;
- Rregullorja (UE) e Komisionit, të 17 qershorit 2013, n. 557/2013, që aplikon rregullorja (CE) n. 223/2009 e Parlamentit europian e e këshillit të statistikave europiane përsa i përket lejes për të dhënat e rezervuara për qëllime shkencore e rrëzon rregulloren (CE) 831/2002 të komisionit (G.U.U.E të 18 qershorit 2013, n.L.164);
- Dekreti legjislativ 06 shtator 1989, n. 322, e ndryshime e plotësime të mëtejshme, “Rregulla për Sistemin statistikor kombëtar e për riorganizimin e Institutin kombëtar të statistikës” – nenet 6-bis (trajtimet e të dhënave personale), 7 (detyrimi për dhënien e të dhënave statistikore), 8 (sekreti profesional i nëpunësve të zyrave të statistikës), 9 (dispozita për mbrojtjen e sekretit statistikor), 13 (Programi statistikor kombëtar);
- Dekreti i Presidentit të Republikës më 07 shtator 2010, n. 166, “Rregullorja për riorganizimin e Institutit kombëtar të statistikës”;
- Dekreti legjislativ 30 qershor 2003, n. 196 e ndryshime e plotësime të mëtejshme “Kodi në lëmin e mbrojtjes së të dhënave personale” – neni 4 (përkufizimet), nenet 104-110 (trajtimi për qëllime statistikore ose shkencore);
- “Kodi i deontologjisë dhe i sjelljes së mirë për trajtimet e të dhënave personale për qëllime statistikore e kërkimore të bëra në kuadrin e Sistemit statistikor kombëtar” (dok. bashkëlidhur A3 i Kodit në lëmin e mbrojtjes së të dhënave personale – d.lgs. 30 qershor 2003 n. 196);
- Dekreti i Kryetarit të Këshillit të Ministrave 21 marsit 2013, - “Programi statistikor kombëtar 2011-2013, axhornimi 2013” (Plotesim ordinar n.47 - (në Gazetën Zyrtare të datës 14 qershorit 2013 – seria e përgjithshme – n.138);
- Dekreti i Presidentit të Republikës të 19 korrikut 2013 “Lista e rëlevimeve statistike, pjesë të Programit statistik kombëtar për tre-vjeçarin 2011-2013 – Axhornimi 2013, për të cilat ekziston detyrimi i subjekteve privatë, të japin të dhënat e informacionet që do u kërkohen, në bazë të artikullit 7 të dekretit legjislativ të 6 shtatorit 1989, n. 322 (të Gazetës Zyrtare të 28 gushtit 2013 – seria e përgjithshme n. 201);
- Dekret ligji i 31 gushtit 2013, n. 101, i konvertuar me modifikime të ligjit të 30 tetorit 2013, n. 125, “Dispozita urgjente për realizimin e objektivave të racionalizimit në administrimin publik” – art. 8-bis, që zgjat efektshmërinë e DPCM të 21 marsit 2013, të aprovimit të Programit statistik kombëtar 2011-2013 – Axhornimi 2013, e të DPR të 19 korrikut 2013, lidhur me detyrimin e përgjigjes, deri në hyrjen në fuqi të Programit statistik kombëtar 2014-2016 (Gazeta zyrtare e 30 tetorit 2013 – seria e përgjithshme – n. 255).